



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:285072

Datë: 12.10.2021

Numri i dokumentit: 02272002

**PKR.nr.96/2020**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË** – Departamenti për Krime të Rënda, trupi i gjykues i përbërë nga gjyqtarët, Shaqir Zika, Kryetari i trupit gjykues, dhe gjyqtarëve Diana Sina dhe Myfera Hoxha, anëtare të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e Sekretares Juridike Nushe Kadrija, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarave V. Ll., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtarë nga neni 422 prg 1 të KPRK-se, veprës penale falsifikimi i dokumentit zyrtar nga neni 434 prg 1 të KPRK-se, të akuzuarës J. A. për shkak të veprës penale deklarimi i rreme nga neni 392 prg 1 të KPRK-se, të akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, - Departamenti për krime të rënda PP/I.nr. 100/2019, të datës 13.04.2020, pas shqyrtimeve gjyqësore publike të mbajtura me datat 16.10.2020, 18.11.2020, 16.12.2020, 08.01.2021, 02.07.2021, 29.07.2021, 03.09.2021, në prezencën e Prokurorit të shtetit Ali Uka, të akuzuarve, V. Ll. dhe mbrojtësi i sajë av. Prenk Pepaj, nga Gjakova, të akuzuarës J. A. dhe mbrojtësit të sajë av.Fadil Sinanaj nga Gjilani, me datën **07.09.2021** mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë **12.10.2021** e përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**E akuzuara:**

**1.V. LL.**, i ati P. , e ëma D., e gjinisë K., data e lindjes . . . në Peje, tani me banim në Gjakovë, ku dhe jeton në rrugën “ . . . “ p.nr. e martuar, nënë e dy fëmijëve, ka të kryer fakultetin e Mjekësisë, Mjekë pranë Spitalit “ Isa Grezda “ në Gjakovë, e gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, me numër personal: . . .

**Ë S H T Ë F A J T O R E**

I.Me datën 15.05.2017, rreth orës 11:00/h, në cilësinë e anëtares së Komisionit për pranimin e një operatori në SISH, ka keqpërdorur detyrën e saj zyrtare duke tejkalluar kompetencat e saja, me qëllim që të sjell dobi pasurore në mënyrë të kundërligjshme për vete dhe të tjerët, si dhe të shkaktoj dëm të tjerëve, në atë mënyrë që gjatë tërë procedurës rekrutimit

sipas konkursit të Spitalit Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë, ka favorizuar kandidaten J. A. që të përzgjidhet në cilësinë e operatores së SISH-it, duke ndërhyrë në test me plotësime shtesë, me ç’rast iu ka shkaktuar dëm kandidatëve tjerë, e cila gjë është vërtetuar nga ekspertiza grafologjike e AKF-së, 2019-2237/2019-1970 të datës 09.09.2019, si dhe ekspertizës plotësuese grafologjike AKF-2021-0139-2021-138 të datës 24.03.2021.

- Me çka ka kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata me aplikimin e neneve 4, 6, 17, 41, 43, 45, 46, 47, par 1, 73 par.1-3, nenit 422 para 1, të KPRK-së, dhe neneve 359 par. 2, 366, 450 të KPPK-se, të akuzuarën e gjykon:

**Të akuzuarës V. Ll. për diapozitivin I të akuzës**, për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 ( gjashtë ) muajve, i cili dënim me kërkesën dhe pëlqimin e të akuzuarës **I zëvendësohet Me Dënim Me Gjore** në shume prej 2.500 (dymijepesëqind) €, e cila gjore duhet të paguhet në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse e akuzuara nuk dëshiron ose nuk mundet të paguajnë dënimin me gjore atëherë të akuzuarës i zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 125 ditë, duke llogaritur për çdo ditë nga 20 (njëzet) €.

**REFUZOHET** propozoi i prokurorisë që ndaj të akuzuarës V. Ll. të shqiptohet dënimi plotësues ndalimi i ushtrimit të profesionit mjekës përkatësisht daktoreshë internistë-pulmologe në Spitalin Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë, në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.

Në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.1 të KPPK-së,

## **REFUZOHET AKUZA**

**II.** Me datën 15.05.2017, rreth orës 11:00/h, ndryshon dokumentin origjinal me qëllim të shfrytëzimit të atij dokumenti si origjinal, në atë mënyrë që në cilësinë e anëtares së Komisionit për pranimin e një operatori në SISH, gjatë procedurës së rekrutimit sipas konkursit të Spitalit Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë, ka ndërhyrë në testin me shkrim të kandidates J. A. duke e ri plotësuar me qëllim që t’ia mundësoj ngritjen e pikëve gjatë vlerësimit të testit me shkrim, ashtu që në bazë të raportit të ekspertimit grafologji të Agjencionit Kosovar për Forenzikë në Prishtinë, me numër 2019-2237/2019-1970 të datës 26.09.2019, janë identifikuar karakteristikat e përgjithshme dhe individuale që përputhen me karakteristikat e dorëshkrimeve të anëtares së komisionit pranues V. Ll. në testin origjinal të kandidates J. A..

-Me çka kishte për të kryer veprën penale falsifikim i dokumentit nga neni 434 par.1 të KPRK-së.

Për shkak të tërheqjes së prokurorit të shteti nga akuza në shqyrtim gjyqësor.

## 2. E Akuzuara:

**J. A.** nga i ati F., e ëma N., e gjinisë I., data e lindjes . . . ne Gjakove , ku dhe jeton ne rrugën “ . . . , e martuar, nënë e tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, e gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, me numër personal: . . .

## Ë S H T Ë F A J T O R E

**III.** Me datën 08.08.2019 rreth orës 09:00/h, gjatë dhënies së deklaratës në cilësinë e dëshmitares së Stacionit policor në Gjakovë, në procedurën penale, me vetëdije paraqet deklaram të rremë, në atë mënyrë që ka deklaruar rrejshëm se kinse gjatë procedurës së rekrutimit sipas konkursit të Spitalit Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë, me rastin e plotësimit të testit me shkrim, nuk e kishte ndihmuar askush nga anëtarët e komisionit, se shkrimi në testin e sajë është i tëri i saj dhe kishte përdorur dy stilolapsa, dhe në bazë të kësaj deklarate arin të punësohet si operatore e SISH-it në Spitalin Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë, duke i dëmtuar kandidatët e tjerë.

- Me çka ka kryer veprën penale deklarami i rremë nga neni 392 par.1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata me aplikimin e neneve 4, 6, 17, 41, 43, 46, 73 par.1-3, dhe neni 392 par.1, të KPRK-së, dhe neneve 359 par. 2, 366, 450 të KPPK-se, të akuzuarën e gjykon.

E akuzuara J. A. për veprën penale deklarami i rremë nga neni 392 par.1 të KPRK-së, **i shqiptohet Dënimi Me Gjobë** në shumë prej pesëqind (500) Euro, i cili dënim duhet të paguhet ne afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi

Nëse e akuzuara nuk dëshiron ose nuk mund të paguajnë dënimin me gjobe atëherë të akuzuarës i zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 25 (njëzetepesë) ditëve, duke llogaritur për çdo dite nga 20 (njëzet) €.

Të pandehurat obligohen që ne emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen me nga 50 (pesëdhjetë) €, si dhe ne emër të programit të kompozimit të viktimave të krimit shumen me nga 50 (pesëdhjetë) €, të gjitha këto ne afate prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimit nën kërcenim të ekzekutimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Gjakovë,-Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP/I nr.100/2019 të datës 13.04.2020, kundër të akuzuarave V. Ll., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-se, veprës penale falsifikimi i dokumentit zyrtar nga neni 434 par.1 të KPRK-së, të akuzuarës J. A. për shkak të veprës penale deklarami i rreme nga neni 392 par.1 të KPRK-se.

Të akuzuarat V. Ll. dhe J. A. ne seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt.25.06.2020, si dhe ne seancën e shqyrtimit kryesor me dt.16.10.2020, janë deklaruar të pa fajshme për veprat penale që i vihen ne barrë sipas aktakuzës.

Gjate shqyrtimeve gjyqësore ne këtë çështje penale përfaqësuesi i shtetit Ali Uka pas mbajtjeve të seancave të shqyrtimeve gjyqësore në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se në

këtë çështje penale kundër të akuzuarës V. Ll. për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par 1, dhe veprës penale falsifikimi i dokumentit nga neni 434 par 1 të KPRK-së, dhe të akuzuarës J. A. për shkak të veprës penale deklarim i rremë nga neni 392 par.1 të KPRK-së, dhe atë pas administrimit të të gjitha provave të administruara në aktakuzë dhe atë provave materiale siç janë: testi me shkrim i kandidates J. A. me numër referues 006/05/2017, formulari për marrjen e dorëshkrimeve dhe nënshkrimeve i L. Ll., i datës 16.08.2019, formulari për marrjen e dorëshkrimeve dhe nënshkrimeve i A. S., i datës 16.08.2019, formulari për marrjen e dorëshkrimeve dhe nënshkrimeve i A. K., i datës 16.08.2019, formulari për marrjen e dorëshkrimeve dhe nënshkrimeve i Z. M., i datës 15.08.2019, formulari për marrjen e dorëshkrimeve dhe nënshkrimeve i J. A.t, i datës 19.08.2019, formulari për marrjen e dorëshkrimeve dhe nënshkrimeve i V. Ll., i datës 15.08.2019, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve me numër të rastit DHKEK-419/19 i datës 31.07.2019, raporti i ekspertizës së grafologjisë me numër referues AKF2019-2237/2019-1970 i datës 09.09.2019, si dhe raporti i ekspertizës plotësuese grafologjisë me numër AKF/2021-0139/2021-138 i datës 24.08.2021, nga provat formale dhe atë dëshmia e ekspertës së grafologjisë L. Sh., si dhe ekspertizës së ekspertës së grafologjisë N. L., të dhënë në këtë shqyrtim gjyqësor e të cilat pos tjerash kanë deklaruar se ka formuluar një udhëzues për marrjen e nënshkrimeve dhe dorëshkrimeve i cili i është shpërndarë gjykatave dhe prokurorive si dhe stacioneve policore në të cilat sqarohet në mënyrë të qartë si duhet të merren dorëshkrimet e që në këtë rast kemi të bëjmë me dorëshkrime ashtu që kërkohet të merret teksti i njëjtë siç është dhe në dokumentin kontestues nëse është e mundur nga rrethanat e ndryshme nëse nuk ka mundësi të sigurohet ky tekst, kërkohet të merren dorëshkrimet tjera për personin apo personat në fjalë. Nga dëshmia e ekspertës së grafologjisë L. Sh., e cila lidhur me atë se si ka arritur deri tek konstatimi i sajë përfundimtar, u deklarua se gjatë ekspertimit të dokumentit nga dëshmia e 6 me rreze fluoro qence është bërë ekzaminimi i faqes së parë nga dorëshkrimi në fjalë ku janë identifikuar dy ngjyra të ndryshme të lapsit kimik ashtu që duke u bazuar në këto të gjetura gjatë ekspertizës në faqen e parë të dokumentit në dorëshkrimin 6, janë përdorur dy ngjyra të ndryshme të lapsit kimik dhe se gjatë ekspertimit të dokumentit 6, janë përdorur pajisjet “VSC 5000”, si dhe mikroskopin “LejcaMZ16”, ashtu që përmes kësaj pajisje ka përdorur rezet fluoeshence dhe aty janë identifikuar që janë përdorur dy ngjyrat apo boja të ndryshme të lapsit kimik.

Kemi vlerësuar raportin e ekspertizës së grafologjisë me numër referues AKF2019-2237/2019-1970 i datës 09.09.2019, në të cilin është konstatuar se dorëshkrimi nga dokumenti në dëshminë I “testi me shkrim me numër referues 006/05/2017 në emër të J. A.t”, është i shkruar nga personi i njëjtë i cili ka shkruar dorëshkrimet mostrat e njohura të evidentuara në dorëshkrimin 5, “formulari për marrjen e dorëshkrimeve dhe nënshkrimeve i datës 15.08.2019 me dorëshkrimin të V. Ll.”, dorëshkrimi i lartcekur është ekspertuar dhe krahasuar me dorëshkrimet mostrat të evidentuara me dorëshkrimet si nën 2 J. A. 3.Z. M., 4. A. K., 6 L. Ll., dhe 7 A. S., mirëpo nuk janë identifikuar karakteristikat të përgjithshme dhe individuale që përputhen në mes tyre, që do të thotë se dorëshkrimi i lartcekur nuk është i shkruar nga personat e lartpërmendur.

Sa i përket veprës penale falsifikimi i dokumentit nga neni 434 par.1 të KPRK-së, për të cilën është akuzuar V. Ll., deklaroi se hekë dorë nga akuza për këtë veprë penale meqenëse vepra penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së e konsumon këtë veprë penale.

Ndërsa deklaroi se mbetem në tërësi pranë akuzës për veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, për të akuzuarën V. Ll. si dhe kundër të akuzuarës J. A. për veprën penale deklarim i rremë nga neni 329 par.1 të KPRK-së, meqenëse me të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor u arrit që të provohet

fajësia e të akuzuarave V. Ll. dhe J. A. ashtu që i propozoi trupit gjykues që të njëjtat të shpallen fajtores, të gjykohen sipas ligjit dhe të obligohen në pagesën e shpenzimeve të procedurës penale.

Propozoi që ndaj të akuzuarës V. Ll. të shqiptohet dënimi plotësues ndalimi i ushtrimit të profesionit mjeke përkatësisht dokoreshë internistë-pulmologe në Spitalin Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë, në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.

Gjykata ka zbatuar procedurën e provave, ka marr në pyetje në cilësi të dëshmitarëve Z. M., A. S.n, A. K., L. Ll.n, J. H., L. Y., ekspertin e grafologjisë N. I., si dhe ekspertin e grafologjisë L. Sh., si dhe ka bërë leximin e provave materiale të propozuara në aktakuzë.

Gjykata ka marr në pyetje në cilësinë e **dëshmitarit Z. (O.) M.**, i cili ka deklaruar se është i punësuar në Spitalin Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë, në vendin e punës Drejtor i Administratës. Nga ana e Drejtorit të Spitalit është caktuar kryetari i komisionit për pranimin e një punëtori të ri të SISH-it, në të cilin komision kemi qenë edhe 5 anëtarë, dhe atë V. Ll., A. K., shef i shërbimit teknik, L. Ll. dokoreshë dhe A. S., infermiere. Pas shpalljes së konkursit dhe aplikimit të kandidatëve unë si kryetare e komisionit i kam ftuar anëtarët në takim, dhe nga personeli kam pranuar dokumentacionin e kandidatëve si dhe testet e zbrazëta. Përpos personelit që kryen punët teknike dhe atë shefja e personelit e cila asiston vetëm në sjelljen e dokumentacionit dhe ndonjëherë asiston edhe përfaqësuesi i sindikatës, e për rastin konkret nuk më kujtohet a ka qenë prezent apo jo. Pasi shpërndahen testet dhe përfundon koha për plotësimin e tij unë si kryetarë i komisionit i kam pranuar testet që i kam pasur në dorë dhe dosjet për çdo kandidat, pas plotësimit të testeve ne si komision kemi vlerësuar kandidatët e para sajë unë si kryetarë i komisionit kam bërë vlerësimin e dokumentacionit se a i plotësojnë kushtet, pastaj i kemi futur kandidatët për testim, dhe unë si kryetar i komisionit i kam shpërndarë testet, i kam sqaruar kandidatëve për rregullat e testimit dhe pasi ka përfunduar testimi këto teste janë dorëzuar në tavolinë ku kam qenë unë së bashku me anëtarët tjerë të komisionit dhe pas përfundimit të testeve me shkrim i kemi vlerësuar këto teste dhe i kemi dhënë pikat çdo kandidati dhe atë çdo anëtarë i komisionit, dhe unë si kryetar i kam vendosur poenët në test. Ndërsa sa i përket testit me gojë, çdo anëtarë i komisionit ka pas të drejtë me i parashtruar pyetje dhe me e vlerësuar kandidatin dhe në funde janë mbledhur të gjitha poenët e testit me shkrim dhe me gojë dhe është përpiluar lista e renditjes sipas poenëve. Të gjithë anëtarët e komisionit gjatë testit me shkrim dhe gojë kanë qenë të pranishëm dhe asnjëri prej tyre nuk ka lëvizur nga salla. Ndërsa sa i përket J. H., i cili është përfaqësues i sindikatës, i njëjti e ka monitoruar procesin, ndërsa L. I., që është shefja e personelit, e njëjta ka asistuar në çështje procedurale por nuk ka marr pjesë në vendim marrje. Unë si kryetar i komisionit kam bërë vlerësimin e përgjigjeve por kur ka pasur ndonjë shkrim të pa lexueshëm të kandidatëve dhe anëtarët tjerë të komisionit kanë bërë leximin e përgjigjeve dhe kandidatët që kanë marr mbi 50% të kalueshmërisë së testit me shkrim kanë fituar të drejtën që të vlerësohen edhe me gojë. Poentimi i kandidatëve e testit me shkrim vlerësimi është bërë nga i gjithë komisioni, pra është merre mendimi i secilit anëtarë të komisionit dhe pas vlerësimit të shumicës ka vendosur unë si kryetar për përgjigje që ka dhënë kandidati dhe i kemi poentuar me pikë të caktuar. Sa i përket të pandehurës V. Ll., që ka qenë anëtare e komisionit, ka deklaruar se ai nuk e ka parë që e njëjta ka ndërhyrë në ndonjë test gjersa ai ka qenë prezent, e sa i përket përfaqësuesit të sindikatës nuk jam i sigurt se a ka qenë prezent në këtë komision ngase ka kaluar një kohë e gjatë apo ndoshta ka mund të jetë prezent, por i njëjti nuk ka pasur mundësi të ndikoi në vendimmarrjen por ka mundë të jetë vetëm monitorues.

Gjykata ka marr në pyetje në cilësinë e **dëshmitarit A. (A.) K.**, i cili ka deklaruar se është i punësuar në Spitalin Regjional “Isa Grezda” në Gjakovë, në vendin e punës shef i shërbimeve teknike. Nga ana e drejtorit ekzekutiv të spitalit jam caktuar si anëtar i komisionit për pranimin e një punëtori, ku kryetar ka qenë Z. M., anëtarët dokoresha V. Ll., dokoresha L. Ll. dhe infermierja A. S.. Ne si komision kemi vlerësuar dokumentacionin e kandidatëve dhe

pasi që i kam plotësuar kushtet për këtë vend të punës ditën e caktuar kryetari i komisionit Z. M., i ka shpërndarë testet kandidatëve që kanë qenë të ulur në sallë dhe çdo kush në ulësen e vetë dhe pas kalimit të afatit të njëjtat teste janë mbledhur dhe ne si komision për secilin kandidatë kemi vlerësuar për çdo pyetje që kanë dhënë përgjigje, i kemi poentuar me pikë të caktuara dhe në funde këto pikë janë mbledhur dhe kush ka pasur përgjigje të 50% të testit ka fituar të drejtën që ti nënshtrohet edhe pyetjeve me gojë, e të cilat përgjigje po ashtu janë vlerësuar nga të gjithë anëtarët e komisionit. Punët teknike janë kryer nga personeli i spitalit, ndërsa ne si komision së pari kemi vlerësuar testin me shkrim dhe ata kandidat që kanë fituar të drejtën që ti nënshtrohen testit me gojë të njëjtit janë vlerësuar nga secili anëtarë i komisionit ku ka qenë lista e vlerësimit dhe në fund kryesuesi i ka mbledhur të gjitha pikat dhe është përzgjedhur kandidati më i suksesshëm. Asnjë nga kandidatët nuk është favorizuar nga asnjëri nga anëtarët e komisionit dhe se nuk i kujtohet me rastin e testimit dhe vlerësimit a ka qenë prezentë përfaqësuesi i sindikatës apo jo. Më vonë pas 3 viteve ka pasur ftesë në polici ku i është kërkuar që të shkruaj në disa fletë të bardha tekstin e diktuar nga ata, po ashtu ka deklaruar se gjatë testimit dhe vlerësimit asnjë nga anëtarët e komisionit nuk ka dalë nga zyra ku është bërë testimi dhe vlerësimi.

Gjykata ka marr në pyetje në cilësinë e **dëshmitares A. (M.) S.**, e cili ka deklaruar se është e punësuar në Spitalin Regjional “Isa Grezda” në Gjakovë, dhe se nga ana e drejtorit ekzekutiv ka qenë e caktuar si anëtare e komisionit, pasi që motra kryesore në atë kohë ka munguar, ka qenë në pushim, atëherë më kanë thirrë mua si zëvendësuese e sajë. Komisionin e ka kryesuar Z. M., në përbërje kanë qenë edhe V. Ll., L. Ll. dhe A. K., pasi që kryetari i komisionit i ka shqyrtuar dokumentacionin kandidatët i janë nënshtuar së pari testit me shkrim e kandidatët që i kanë plotësuar pyetjet e sakta që e kanë arritur 50%, pastaj i janë nënshtuar edhe testit me gojë. Vlerësimi i kandidatëve është bërë nga të gjithë anëtarët e komisionit, të njëjtit janë vlerësuar me pikat dhe se gjatë testimit të gjithë kemi qëndruar në sallë, kurrkush nuk ka lëvizur prej anëtarëve të komisionit, ndërsa a ka qenë prezent përfaqësuesi i sindikatës gjatë këtij procesi nuk i kujtohet.

Gjykata ka marr në pyetje në cilësinë e **dëshmitares L. (M.) Ll.**, e cili ka deklaruar se është e punësuar në Spitalin Regjional “Isa Grezda” në Gjakovë, në vendin e punës mjeke specialiste alergologe-imonologe, nga ana e drejtorit është caktuar anëtare e komisionit për pranimin e një punëtori, dhe të gjitha punët janë kryer nga kryesuesi i komisionit dhe pas përfundimit të tekstit me shkrim, secili nga kandidatët që kanë aplikuar janë vlerësuar me pikë nga çdo anëtarë i komisionit. Gjatë procesit të testimit dhe vlerësimit, askush nga anëtarët e komisionit nuk ka lëvizur nga salla ku është mbajtur testimi. Vlerësimi i testit me shkrim së pari është bërë nga kryesuesi i komisionit ndërsa gjatë testit me gojë secili nga anëtarët e komisionit ka vlerësuar me pikë individuale. Askush nga kandidatët nuk është favorizuar nga ana e komisionit dhe nuk kemi pasur ndonjë preferencë për ndonjë kandidat të caktuar, ndërsa sa i përket kandidatët J. A. të njëjtën e kam njohur figurativisht po ashtu i kam njohur edhe kandidatët tjerë dhe vendimi për pranimin e kandidates J. A. ka qenë vendimi i komisionit, pasi që e njëjta i ka marr më së shumti pik, e sa i përket testit me shkrim të gjithë anëtarët e komisionit i kemi dhënë pikët të njëjta qysh e ka vlerësuar kryetari i komisionit, ndërsa për pyetjet me gojë vlerësimi është bërë individual për secilin kandidat.

Sipas propozimit të mbrojtësit të akuzuarit V. Ll., **dëshmitarja L. Ll. është rimarr** në pyetje pasi që e akuzuara V. Ll. në seancën e datës 02.07.2021, pas dhënies së mbrojtjes së sajë, i ka propozuar gjykatës që si provë materiale të bëhet dëgjimi i video incizimit, ku dëgjohet biseda në mes të pandehurës V. Ll. dhe dëshmitares L. Ll., ku e akuzuara pretendon se L. Ll. i ka konfirmuar V. Ll. që këto të dyja e kanë parë përfaqësuesin e sindikatës J. H. duke ndërhy në testin me shkrim të kandidates J. A. dhe pas dëgjimit të kësaj video është rimarr në pyetje dëshmitarja L. Ll. dhe pas dëgjimit të videos në prezencën e sajë e njëjta ka deklaruar se nuk e din se kush e ka bërë këtë incizim, dhe ky incizim ka ndodhur para dy viteve pasi që unë me të

akuzuarën V. Ll. nuk komunikoi dhe e njëjta incizimin e ka bërë për qëllimet e veta në zyrën e sajë të punës. Ka deklaruar se pasi që e akuzuara V. Ll. është marr në pyetje në polici lidhur me rastin, në atë kohë ajo ka kërkuar që unë të bëhem dëshmitare për këtë rast dhe se fillimisht nga keqardhja i kam thënë se do të bëhem dëshmitare por nuk isha e sigurve në lidhje me rastin por ka deklaruar se është e vërtetë që është zëri i sajë që ka biseduar me të akuzuarën V. Ll. dhe ky incizim është keqpërdorur nga e njëjta. Në pyetjen e parashtruar nga gjykata se a ka njohuri se në testin e kandidatës e J. A. ka ndërhy J. H., e njëjta ka deklaruar se nuk i kujtohet dhe nuk isha e sigurve në fillim mu ka dhimbur si kolege i kam thënë se do të dëshmoi por më vonë kam refuzuar të bëhem dëshmitare që e kam parë J. H. të ndërhy në test ngase për këtë nuk kam qenë e sigurve dhe se që nga ky rast tani me të akuzuarën V. Ll. nuk komunikojmë.

Gjykata ka marr në pyetje në cilësinë e dëshmitares sipas propozimit të mbrojtjes **dëshmitaren L. (B.) Y.**, e cili ka deklaruar se është e punësuar në Spitalin Regjional “Isa Grezda” në Gjakovë, në vendin e punës shefja e njësisë së burimeve njerëzore dhe me profesion është juriste. I kujtohet se në vitin 2017, ka pasur një numër të madh të lëndëve të regrutimit të punëtorëve. Sa i përket punëtores së pranuar J. A. nuk i kujtohet se kush kanë qenë anëtarët e komisionit por pasi kam ardhur në gjykatë e kam shikuar dosjen dhe kamë parë se kryesuesi i komisionit ka qenë Z. M., anëtarët V. Ll., L. Ll., A. K. dhe A. S.. Në këtë procedurë të rivotimit nuk më kujtohet se a ka qenë prezent përfaqësuesi i sindikatës pasi që ka kaluar një kohë e gjatë dhe ajo shumë procedura të regrutimit i ka mbajte dhe nuk mund të mbaj në mend. Unë si juriste i pranoi aplikacionet e kandidatëve, ndërsa testet me pyetjet vijnë nga zyra e drejtorit ku unë nuk kam qasje dhe se komisioni punon në mënyrë të pavarur. Testet me shkrim i mbanë kryesuesi i komisionit i cili punon me anëtarët e komisionit dhe i mban deri tek përfundimi i procedurës së testit me shkrim dhe me gojë, pas kësaj i mbushin formularët, e bëjnë ranglistën e kandidatëve dhe shpallet fituesi atëherë ky dokumentacion del tek unë dhe këto i sjell kryesuesi i komisionit dhe ai mbanë të gjithë përgjegjësinë.

Po ashtu sipas propozimit të mbrojtjes gjykata ka proceduar **dëshmitari J. (R.) H.**, i cili ka deklaruar se është i punësuar në Spitalin Regjional “Isa Grezda” në Gjakovë, në vendin e punës së laborantit dhe se i njëjti është anëtarë i sindikatës dhe zakonisht përfaqësuesi i sindikatës merr pjesë në procesin e regrutimit të punëtorëve e sa i përket rastit konkret nuk i kujtohet që ka qenë prezent në këtë raste pasi që ka kaluar një kohë e gjatë duke shtuar se ka harresë pasi që vuan nga sëmundja e kancerit dhe tani është me kimio-terapi, dhe të njëjtit nuk i kujtohen gjërat dhe ka filluar ti harroi emrat e familjarëve të vet. Zakonisht ne si përfaqësues të sindikatës kemi të drejtë të shkojmë si vëzhgues por nuk kemi të drejtën e vendimmarrjes, zakonisht ulemi në skaj të sallës dhe bëjmë vëzhgimin e procesit.

Gjykata ka procedura në cilësinë e **ekspertes së grafologjisë ekspertin N. (I.) I.**, specialiste e lartë për dokumente dhe dorëshkrime, e punësuar pranë AKF në Prishtinë, e cila ka deklaruar se sipas urdhëresës së lëshuar nga Prokuroria Themelore në Gjakovë, kam përpiluar raportin e ekspertimit me numër referues AKF-2019-2237/2019-1970, e cila urdhëresë është pranuar në AKF me datën 29.08.2019, ndërsa ekspertimin e kam përfunduar me datën 09.09.2019, ku është kërkuar të bëhet ekzaminimi grafologjik i dorëshkrimit të mostrës kontestuese të testit me shkrim me numër referues 006/05/2017 në emër të J. A. t nga Gjakova, është kërkuar ekzaminimi dhe krahasimi i dorëshkrimit me shkrim, në pyetjen dy të testit duke filluar nga gjysma e rreshtit të dytë që është shkruar me ngjyrë të kaltër të mbyllur si dhe në pyetjen e katërt në teste të katër rreshtat dhe në pyetjen e pestë në teste tërësi. Në Agjencinë të Kosovës për Forenzik në divizionin e dokumenteve dhe dorëshkrimeve, kemi një udhëzues për marrjen e dorëshkrimeve dhe nënshkrimeve i cili udhëzues i është dhënë gjykatave dhe prokurorive dhe aty sqarohet se si duhet të merren dorëshkrimet në këtë raste kemi të bëjmë me një raste me një dorëshkrim. Kërkohe të merret testi i njëjtë siç është në dokumentin kontestues nëse është e mundur nga rrethanat e ndryshme nëse nuk ka mundësi me u siguruar ky tekst,

kërkohe të merren dorëshkrimet të tjera ku mund të ketë shkruar personi apo personat në fjalë. Në rastin konkret është kërkuar të bëhet ekzaminimi grafologjik i dorëshkrimeve të plotësuara në formularët për marrjen e dorëshkrimeve, të kandidatës J. A. dhe personat të dyshuar, Z. M., A. K., Venera Ll., L. Ll. dhe A. S., ku është kërkuar të bëhet krahasimi në mes të dorëshkrimit në dokumentin kontestues, testin me shkrim me numër referues: 006/05/2017 në emër të kandidatës J. A. me dorëshkrimet në formularët për marrjen e dorëshkrimeve të persona të dyshuar si të cekur si më lartë dhe se materiali kontestues tre fletë të dorëshkrimit të titulluar “testi me shkrim të kandidatës J. A.”, dhe pasi që kemi përdorur metodën dhe pajisjet e përdorura të procedurës standarde të operimit, kemi ardhur tek konstatimi dhe mendimi përfundimtarë se në bazë të rezultateve të ekspertimit konstatohet se dorëshkrimi i lartcekur nga dokumenti në dorëshkrim 1 është i të njëjtit person i cili ka shkruar dorëshkrimet, mostrat të njohura të evidentuara në dëshminë 5 që janë të V. Ll., ndërsa në bazë të rezultatit të ekspertimit konstatohet se dorëshkrimi i lartcekur nga dokumenti në dëshminë 1 nuk është i shkruar nga personat e evidentuara në dëshminë 2 (J. A.) dëshminë3 ( Z. M.) dëshmia 4 (A. K.) dëshmia 6 (J. Ll.) dhe dëshmia7 (A. S.).

Gjykata ka refuzuar kërkesën e mbrojtësit të akuzuarës av.Prenk Pepaj, që të bëhet super ekspertizë në këtë çështje, pasi që në këtë çështje nuk janë bërë dy ekspertiza që janë në kundërshtim me njëra tjetrën, andaj me urdhëresë të veçantë ka urdhëruar që të bëhet ekspertizë plotësuese për ekzaminimin e dorëshkrimeve, gjegjësisht krahasimin e dorëshkrimeve të përshkruara nga e akuzuara V. Ll. dhe J. A. dhe në bazë të ekspertizës plotësuese nga ekspertja e grafologjisë L. Sh., e cila ka prezantuar në seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe e njëjta ka përpiluar raport të ekspertimit me numër referues AKF/2021-10139/2021-138 të datës 24.03.2021, dhe e njëjta ka dhënë konstatim dhe mendim përfundimtar duke u bazuar në të gjeturat- karakteristikat e përgjithshme dhe individuale, ka ardhur në përfundim se shkrimi në dëshminë 6, është shkruar nga personi i njëjtë me mostrat e shkrimeve nga dokumenti në dëshminë #2 dhe #3.

Duke u bazuar në të gjeturat ka ardhur në përfundim se në faqen e parë të dokumentit në dëshminë 6, janë përdorur dy ngjyra të ndryshme të lapsit kimik.

Gjykata ka administruar provat materiale ka lexuar raportin e oficerit policor D. L, me numër 2019-KE-434 të datës 09.10.2019. Gjykata ka bërë shikimin në testin me shkrim të kandidatës J. A. me numër referues 006/05/2017, ka bërë leximin në formularin për marrjen e dorëshkrimeve dhe nënshkrimeve të L. Ll., të datës 16.08.2019, ka bërë leximin në formularin për marrjen e dorëshkrimeve dhe nënshkrimeve të A. S. të datës 16.08.2019, ka bërë leximin e formularit për marrjen e dorëshkrimeve dhe nënshkrimeve të A. K., të datës 16.08.2019, ka bërë leximin e formularit për marrjen e dorëshkrimeve dhe nënshkrimeve të Z. M. , të datës 15.08.2019, ka bërë leximin e formularit për marrjen e dorëshkrimeve dhe nënshkrimeve të J. A.t, të datës 19.08.2019, ka bërë leximin e formularit për marrjen e dorëshkrimeve dhe nënshkrimeve të V. Ll., të datës 15.08.2019, gjykata ka bërë shikimin dhe leximin e vërtetimit mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve me numër të rastit DHKEK-419/2019 të datës 31.07.2019, ka bërë shikimin në raportin e ekspertizës grafologjike me numër referues AKF/2019-2237/2019-1970 të datës 09.09.2019, si dhe ka bërë leximin e ekspertizës plotësuese grafologjike AKF/2021-0139/2021-138 të datës 24.03.2021.

Gjykata ka bërë dëgjimin e incizimit nga CD-ja, dhe atë nga biseda e bërë mes të akuzuarës V. Ll. dhe dëshmitares L. Ll., biseda ka të bëjë në lidhje me pranimin e kandidatës J. A. ku në komision kanë qenë këtu e akuzuara dhe dëshmitarja dhe dëgjohet biseda ku e akuzuara V. Ll. thotë se nëse nuk e pranon përfaqësuesi i sindikatës që ka ndërhy në tekst atëherë ajo do ti tregojë organeve të ndjekjes dhe dëshmitarja i thotë të akuzuarës se do të bëhet dëshmitare nëse ajo është e sigurve që ka ndërhy përfaqësuesi i sindikatës e më vonë L. Ll. i thotë



të akuzuarës Verës se nuk mund të bëhet dëshmitare pasi që nuk është e sigurve që ka parë J. H., duke ndërhy në testin e J. A.t.

**E akuzuara V. Ll.** në mbrojtje te vet dhe në fjalën e sajë përfundimtare ka deklaruar se: me profesion është mjekë-interniste-pulmologe, dhe ka të kryer specializimin mjekësi interne-pulmologji, dhe është e punësuar në Spitalin Regjional “Isa Grezda” në Gjakovë. Nga ana e drejtorit të spitalit jam emëruar anëtare e komisionit për pranimin në punë të një operatori në SISH, ku kryetari i komisionit ka qenë Z. M., ndërsa anëtarë unë, kolegja L. Ll., A. K., A. S. dhe prezent ka qenë përfaqësuesi i sindikatës J. H.. Pasi që kryetari i komisionit i ka shpërnda testet kandidatëve, ne si komision kemi qenë të ulur në tavolinë dhe pas plotësimit të testeve nga ana e kandidatëve disa kandidat i kanë dorëzuar kryetarit të komisionit, disa të tjerë i kanë lënë në tavolinë dhe me rastin e vlerësimit të testeve, kryetari i komisionit na ka referuar neve për secilin kandidatë, kemi dhënë vlerësimin tonë për secilin kandidat dhe i kemi poentuar me pikë të caktuar, kandidaten J. A. e kam njohur si figurë dhe nuk janë të vërteta pretendimet e prokurorisë që unë kinse kamë ndërhy në testin e sajë por këtë e ka bërë përfaqësuesi i sindikatës J. H., dhe këtë e kam parë vetë që ky ka ndërhy në këtë teste, po ashtu këtë e ka parë edhe kolegja ime L. Ll., dhe unë pasi që kam dhënë deklaratë në polici, dhe pas pranimit të ekspertizës grafologjike e ku në këtë ekspertizë është dhënë mendimi përfundimtar se në testin e kandidates J. A. ka ndërhyrë me plotësim në këtë test, dhe kinse këtë plotësim e kam bërë unë, që kinse dorëshkrimi është i imi, unë pas këtij momenti së pari kam biseduar me tani të ndjerin J. H, që ai të deklarohet para organeve dhe të pranoi fajësinë, i njëjti nuk ka pranuar asses, dhe pas kësaj kam biseduar me doktoreshën L. Ll., kam biseduar me te që J.i ta pranoi fajësinë ngaqë ai e ka bërë këtë ndërhyrje, i cili ka refuzuar kategorikisht, i cili person është proceduar në cilësinë e dëshmitarit në këtë shqyrtim gjyqësor, i cili edhe në shqyrtim gjyqësor ka mohuar që ka qenë i involvuar në këtë raste dhe tani e zhgënjyer kam biseduar me kolegen time L., dhe këtë bisedë e kam incizuar në telefonin tim e cila në fillim më ka përkrahur dhe ajo ka deklaruar se e ka parë përfaqësuesin e sindikatës J. H., duke ndërhy në testin e kandidates J. A. mirëpo më vonë edhe ajo ka hekur dorë dhe nuk ka dashur të dëshmoi duke deklaruar se ajo nuk është e sigurve për këtë. Unë personalisht kamë vërejtur që ditën kritike pas testit me shkrim, J. H., pasi që kemi dalë nga salla ka hy në një dhomë tjetër që është si një lloje kuzhine dhe unë kam qenë në anën e kundërt të tavolinës, J.i ka qenë në anën tjetër të tavolinës, ku unë kam qenë së bashku me doktoreshën L., dhe kemi parë që i njëjti ka ndërhy në testin e J. A.t. Ka mohuar kategorikisht që e ka kryer këtë vepër në seancën e shqyrtimit gjyqësor kur është proceduar dëshmitari J. H., pasi që i njëjti ka qenë në gjendje shumë të rëndë shëndetësore, ka qenë me sëmundje të kancerit, dhe kur është kthyer ekspertiza plotësuese grafologjike dhe pasi që kam parë që prapë ekspertët e grafologjisë kanë dhënë mendim të njëjtë atëherë kam qenë e detyruar të tregoi se kush ka ndërhyrë në këtë test. I ka propozuar gjykatës që të lirohet nga akuza ngase këtë vepër nuk e ka kryer.

**E akuzuara J. A.** ne mbrojtje te vete dhe ne fjalën e sajë përfundimtare ka deklaruar se: ka të kryer shkollën e mesme ekonomike dhe punon si operatore në SISH (sistemi informativ shëndetësor) pranë Spitalit Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë, në administratë që nga korriku i vitit 2017. Kam aplikuar për këtë vende të punës, pasi që i kam plotësuar kushtet ligjore, i jam nënshtruar testit me shkrim si dhe testit me gojë dhe sipas njoftimit të komisionit kam qenë e rënduar e para në listë dhe kam themeluar marrëdhënien e punës. Gjatë përpilimit të testit me shkrim stilolapsi kimik më është sosë dhe nga komisioni kam kërkuar lapsë kimik tjetër dhe kam vazhduar me test, sipas meje çdo gjë ka qenë në rregull, dhe në vitin 2019, kam pasur ftesë që të paraqitem në polici që të jap deklaratë dhe atje jam pyetur lidhur me testin që e kam mbushur me shkrim, kam treguar që kam aplikuar si çdo kandidat tjetër dhe kam thënë që testin me shkrim e kam përpiluar vetë. Në polici kanë kërkuar që të bëjë testimin e një testin dhe të njëjtin e kanë dërguar në grafologji. Në polici herën e parë jam marrë në pyetje në cilësinë e dëshmitares, me datë 08.08.2019, ku në pyetjen e parashtruar nga zyrtari policor se a është shkrimi i juaj plotësisht

në testin origjinal të datës 09.06.2017, kamë deklaruar se ky shkrim është plotësisht i imi dhe se me rastin e dhënies së përgjigjeve kam përdorur dy stilolapsa. Po ashtu kam deklaruar se me rastin e përpilimit të testit me shkrim nuk më ka ndihmuar askush nga anëtarët e komisionit, po ashtu i është prezantuar testi me shkrim dhe ka deklaruar se ky test është plotësuar nga ana e sajë dhe se në polici është marr në pyetje pas dy viteve dhe zyrtari policor ma ka prezantuar këtë test pas shikimit kam parë që është shkrimi imë por kjo ka zgjatur disa sekonda, dhe unë testin nuk e kam lexuar në tërësi, dhe se në atë kohë kam qenë e stresuar, ka qenë hera e parë që jam ftuar në polici dhe burrin e kam pasur të sëmur dhe kam pasur probleme shëndetësore me sy, kam pasur tension. Në pyetjet e parashtruara nga ana e gjykatës se a qëndroni pranë deklaratave që i keni dhënë në polici me datën 08.08.2019 dhe në Prokurori me datën 25.02.2020, ka deklaruar se në tërësi qëndron pranë këtyre deklaratave dhe se gjatë shikimit të testit mu ka dukur se ka qenë shkrimi imë dhe kjo ka qenë shumë kohë e shkurtë, nuk kam pasur për qëllim që të jap deklaratë të rreme në këtë çështje penale, andaj i ka propozuar gjykatës që ta liroi nga akuza.

**Mbrojtësi i të akuzuarës V. Ll. av.Prenk Pepaj**, ne fjalën e tij përfundimtarë ka deklaruar se: aktakuza e ngritur kundër të mbrojturës sime është ngritur në kundërshtim me nenin 262 par.1 të KPRK-së, pasi që aktakuza e ngritur duke u mbështetur në një provë të vetëm dhe atë ekspertizës së ekspertit të grafologjisë.

Me rastin e procedimit të dëshmitarëve, që të gjithë dëshmitaret janë deklaruar se ditën e mbajtjes së testit me shkrim, asnjëri nga anëtarët e komisionit nuk është ngritur nga vendi ku është mbajtur testi dhe deri në përfundim të testit me shkrim dhe se testet janë dorëzuar nga ana e kandidatëve, kryetarit të komisionit, ose testet që janë lënë nëpër vende, i ka mbledhur kryetari i komisionit, dhe testet ia ka dorëzuar përfaqësuesit të sindikatës. E akuzuara V. Ll., nuk ka pasur asnjë kontakt me asnjë kandidat, dhe nuk ka pasur në dorë testet e as që ka mundur të ndërhy në këto teste. Andaj parashtrohet pyetja se si ka mund të ndërhy në testin e të akuzuarës J. A. kur nuk është ngritur nga vendi gjatë gjithë kohës së mbajtjes së testit, nuk ka pasur në dorë asnjë test, dhe nuk ka pasur asnjë kontakte me asnjë nga kandidatët.

Në raste se analizohen me kujdesë që të dy ekspertizat, parashtrohet pyetja se si është e mundur që të intervenohet në test në mes të rreshtit, apo në funde të rreshtit apo ti shtohet një pjesë e fjalës e të mos ketë pothuajse ndryshim në strukturën e fjalës apo fjalisë. Pra nga kjo rrjedhë se në rastin konkret ekspertiza grafologjike nuk mund të bëhet nga ekspertët të cilët janë trajnuar me 3 apo 6 muaj, pra të njëjtit nuk kanë përgatitje të mirëfilltë profesionale, për përpunimin e ekspertizave grafologjike. Andaj për këtë arsye gjatë procedurës kemi pasur vërejtje në ekspertizat dhe kemi propozuar super ekspertizë.

Me rastin e procedimit të akuzuarës i njëjti ka deklaruar se në teste është intervenuar nga ana e përfaqësuesit të sindikatës tani të ndjerit J. H., çka është vërtetuar edhe nga audio-video-incizime i bisedës së zhvilluar në mes të akuzuarës V. Ll. dhe dëshmitares L. Ll., ku dëshmitarja L. Ll., deklarohet se në test është intervenuar nga përfaqësuesi i sindikatës tani të ndjerit J. H., dhe se e mbrojtura ime më herët për këtë fakt nuk është deklaruar duke marr parasysh se nuk ka intervenuar në testin e të akuzuarës J. A. duke pasur parasysh traditën tonë, gjendjen shëndetësore me rastin e procedimit të dëshmitarit tani të ndjerit J. H., si dhe duke besuar në drejtësi se gjatë procedurës do të vërtetohet gjendja faktike, pra e vërteta do të dalë në shesh, pra se do të vërtetohet se nuk është fajtorë. Andaj duke cekur si më lartë i ka propozuar gjykatës që e njëjta në mungesë të provave të lirohet nga akuza.

**Mbrojtësi i të akuzuarës J. A. av. Fadil Sinanaj**, ne fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar, pas mbajtjes së seancave të shqyrtimeve gjyqësore, referuar dëshmime të prezantuar nga prokuroria, provave me të cilat prokuroria pretendon të vërtetoi akuzën lëndore, sipas vlerësimit të palës mbrojtëse të njëjtat nuk paraqesin asnjë bazë të vetmen ligjore dhe vendimtare

për gjetjen fajtores e të akuzuarës lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet, në të cilën mbrojtësi i të pandehurës, kërkojmë nga ana e gjykatës që të ketë parasysh rrethanat dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor të cilat vërtetojnë faktet kryesore dhe arsyetojnë pa fajësinë e të akuzuarës J. A. dhe se duke u bazuar në shkresat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se e pandehura të ketë kryer veprën penale si në aktin akuzues. E akuzuara J. A. gjatë shqyrtimit gjyqësor, është provuar që të inkriminohej në këtë çështje penale mbi bazën e kinse të deklaramit të marrjes në pyetje në polici në cilësi të dëshmitares. Gjatë marrjes në pyetje në polici në cilësi të dëshmitares, e njëjta ka qenë në gjendje jo të mirë shëndetësore në aspektin psikik për shkak të ngarkesave familjare dhe stresit që është gjendur në stacionin policor, ndriçimit jo adekuat të vendit në të cilin është marr në pyetje dhe koha e shkurtër e shikimit të testit me shkrim, ku e njëjta ka arritur të lexoi vetëm përgjigjen e pyetjes së parë dhe se i është dukur shkrimi që është i sajë. Nga ekspertiza grafologjike është konstatuar se nuk ka ndërhyrje nga askush ( personat tjerë), dhe se nga pohimi i të akuzuarës se: po, me sa po shoh ky shkrim është i imi, pa i lexuar të gjitha përgjigjet, oficeri policor ka konstatuar se e njëjta ka dhënë deklaramit të rremë, e në fakte e njëjta është dashur që ta obligoi J. A.n, që ti lexoi të gjitha përgjigjet e jo vetëm disa sekonda, t'ia lë testin për shikim dhe të shkruaj përgjigjet në procesverbalin e marrjes në pyetje të dëshmitares, kinse J. A. ka deklaruar se shkrimi është plotësisht i imi.

Sa i përket pyetjeve të bëra nga oficeri policor e më vonë nga prokurori dhe gjykata, se a ka ndërhyrë dikush në testin tuaj, e njëjta është përgjigjur se derisa ajo ka pasur testin në posedimin e sajë dhe derisa e ka dorëzuar tek komisioni, është vërtetuar se askush nuk ka ndërhyrë në atë test, gjë që kanë dëshmuar edhe dëshmitarët e proceduar si dhe video-incizimin të cilin e ka sjellë e akuzuarës V. Ll., ku në bashkë bisedimin e sajë me një kolege të vete e thekson se: testi i J. A.t është plotësuar ( nënkuptohet në disa pjesë të përgjigjeve e jo në tërësi) pasi që është bërë vlerësimi i atij testi, e që ka dalë të jetë testi me pika më së shumti se testet e kundër kandidatëve dhe se J. A. nuk e di se të njëjtës i është prekur- ndërhyrë në testin e saj.

Në aktakuzë prokurori ka shënuar se e akuzuara J. A. në bazë të deklaratës së rremë, arrin të punësohet si operatore në SISH në spitalin “Isa Grezda” në Gjakovë, gjë që nuk është e vërtetë sepse J. A. është punësuar në vitin 2017, ndërsa deklaratën në polici në cilësinë e dëshmitares e ka dhënë me datën 08.08.2019, ashtu që dy vite pas punësimit, pra kjo deklaratë e sajë fare nuk ka të bëjë me punësimin e sajë, dhe se e njëjta askënd nuk e ka dëmtuar.

Mbrojtja konsideron se duke iu referuar të gjitha provave dhe deklaramite të bëra në këtë proces gjyqësorë, gjykata tash më është e bindur se janë vërtetuar të gjitha faktet se ndaj të akuzuarës J. A. nuk mund të gjendjen veprime inkriminuese të pretenduara nga prokuroria e shetit lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet andaj në kuptim të dispozitave të nenit 364 par.1 nën par 1.3 të KPPK-së që të merr aktgjykim lirues ngase nuk është provuar se e akuzuara ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Andaj duke u nisur nga të gjitha të dhëna të parashtruar si më lartë i propozoi Gjykatës që ndaj të njëjti të mi rretë aktgjykim lirues, meqenëse nuk është provuar se i njëjti ka kryer vepër penale për të cilën akuzohet.

Pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësore dhe administrimit të provave si dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhshmëri me provat tjera, komform nënti 361 të KPPK-se Trupi Gjykses ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se këtu e akuzuara V. Ll. I.Me datën 15.05.2017, rreth orës 11:00/h, në cilësinë e anëtares së Komisionit për pranimin e një operatori në SISH, ka keqpërdorur detyrën e saj zyrtare duke tejkualuar kompetencat e saja, me qëllim që të sjell dobi pasurore në mënyrë të

kundërligjshme për vete dhe të tjerët, si dhe të shkaktoj dëm të tjerëve, në atë mënyrë që gjatë tërë procedurës rekrutimit sipas konkursit të Spitalit Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë, ka favorizuar kandidaten J. A. që të përzgjidhet në cilësinë e operatores së SISH-it, duke ndërhyrë në test me plotësime shpesh, me ç’ rast iu ka shkakuar dëm kandidatëve tjerë, e cila gjë është vërtetuar nga ekspertiza grafologjike e AKF-së, 2019-2237/2019-1970 të datës 09.09.2019, si dhe ekspertizës plotësuese grafologjike AKF-2021-0139-2021-138 të datës 24.03.2021.

Kjo gjendje faktike është vërtetuar nga ekspertiza grafologjike e ekspertes së grafologjisë N. L., e cila në ekspertizën e përpiluar në formë të shkruar ka dhënë konstatim dhe mendim përfundimtar se pas ekzaminimit grafologjik të dorëshkrimit të mostrave kontestuese të testit me shkrim me numër referues 006/05/2017 në emër të J. A. nga Gjakova, pas ekzaminimit dhe krahasimit të dorëshkrimit në testin me shkrim, në pyetjet dy teste duke filluar nga gjysma e rreshtit të dytë, që është shkruar me ngjyrë të kaltër të mbylltë, në pyetjen e katërt në teste të katër rreshtat, dhe në pyetjen e pestë në teste në tërësi, pas krahasimit në mes të dorëshkrimit në dokumentin kontestues dhe personave të dyshuar të poshtë shënuar të Z. M., A. K., V. Ll., L. Ll. dhe A. S., ku materiali kontestues kam qenë dëshmia 1.3 fletë të dorëshkrimit, të titulluar “testi me shkrim” me numër referues 006/05/2017, në testin e J. A. dhe se gjatë ekspertimit të dokumenteve të cekura që në vijim: dorëshkrimi në rubrikën nr.2 “ jam person që përshtatem shpejtë në punë të ndryshme që më kërkohen”, në rubrikën nr.4 “ është njësi obligative në të gjitha institucionet shëndetësore, bënë përmbledhje, kontrollimi, futjen dhe përpunimin e fletëzave kompjuterike për pacient dhe personel shëndetësor”, si dhe në rubrikën nr.5 “ për punë në programet e SISH-it”, faqja e parë e dokumentit të titulluar “testit me shkrim i evidentuar në dëshminë nr.1, janë identifikuar karakteristikat të përgjithshme dhe individuale që përputhen me karakteristikat e dorëshkrimeve të evidentuara në dëshminë nr.5 (V. Ll.), disa nga karakteristikat të përbashkëta tek dorëshkrimet e lartcekura janë të cekura si në vijim: përpunimi dhe pjerrtësia e dorëshkrimit, pozicioni i pikës fillestare gjatë ndërtimit të shkronjave apo elementeve të tyre “ a,p,d,” veçoritë e lidhjes së shkronjave me njëra tjetrën “ s-h, t-a, t-e, v-e, d-h, si dhe shkëputja e dorës gjatë të shkruarit para ose pas shkronjave të cituara, dhe ka dhënë mendim përfundimtar se në bazë të rezultateve të ekspertimit konstatohet se dorëshkrimi i lartcekur në dokumentin 1 është i shkruar nga personi i njëjtë, i cili ka shkruar dorëshkrimet, mostrat të njohura të evidentuar në dëshminë 5 (V. Ll.).

Ndërsa në bazë të rezultateve të ekspertimit konstatohet se dorëshkrimi i lartcekur nga dokumenti në dëshminë 1 nuk është i shkruar nga personat e evidentuar në dëshmitë: 2 (J. A.), 3 (Z. M.) 4 (A. K.) 6 (L. Ll.) dhe 7 (A. S.).

Po ashtu nga ekspertiza plotësuese grafologjike e përpiluar nga ekspertja e grafologjisë L. Sh., dhe e verifikuar nga eksperti i dytë verifikues R. S., specialistë i lartë për dokumente dhe dorëshkrime i datës 24.03.2021, ku nga rezultati i ekspertimit është konstatuar se gjatë ekspertimit të shkrimit në dokumentin në dëshminë 6 në rubrikën nr. 2, “ jam person që përshtatem shpejtë në punë të ndryshme që më kërkohen”, në rubrikën 4 “ është njësi obligative në të gjitha institucionet shëndetësore. Bënë përmbledhjen e kontrollit, futjen dhe përpunimin e fletëzave kompjuterike për pacient dhe personel shëndetësor”, si dhe në rubrikën nr.5 “ në punën e programit SISH”, janë identifikuar karakteristikat të përgjithshme dhe individuale që përputhen me karakteristikat e shkrimeve të evidentuara në dëshminë 2 dhe 3, dhe ka dhënë konstatim dhe mendim përfundimtar duke u bazuar në të gjeturat-karakteristikat e përgjithshme dhe individuale vinë në përfundim që shkrimi në dëshminë 6 është shkruar nga personi i njëjtë me mostrat e shkrimeve nga dokumenti në dëshminë #2 dhe 3.

Duke u bazuar në të gjeturat ka ardhur në konstatim dhe mendim përfundimtar se karakteristikat e përgjithshme dhe individuale vij në përfundim që shkrimi në dëshminë 6 është

shkruar nga personi i njëjtë me mostrat të shkrimeve nga dokumenti në dëshminë #2 dhe 3, pra i përkasin dorëshkrimeve të akuzuarës V. Ll..

Duke u bazuar në të gjeturat vijë në përfundim se në faqen e parë të dokumentit në dëshminë 6 se në faqen 1 të dokumentin në dëshminë 6 janë përdorur dy ngjyra të ndryshme të lapsit kimik.

Gjykata ka hedhur poshtë mbrojtjen e te akuzuarës V. Ll., e cila ka mohuar veprimet inkriminuese siç akuzohet në aktakuzë nga se mbrojtja e sajë është në kundërshtim me provat e administruara dhe atë ekspertiza e ekspertës së grafologjisë N. I., si dhe verifikuese së dytë V. M., e cila në konstatimin dhe mendimin përfundimtar ka konstatuar se nga dokumenti në dëshminë 1 është i punuar nga personi i njëjtë i cili ka shkruar dorëshkrimet mostrat të njohura të evidentuara në dëshminë 5, pra të akuzuarës V. Ll., ndërsa në bazë të rezultatit të ekspertimit ka konstatuar se dorëshkrimi i lartcekur nga dokumenti në dëshminë 1 nuk është i nënshkruar nga personat e evidentuar në dëshminë; 2 (J. A.), 3 (Z. M.), 4 (A. K.), 6 (L. Ll.) dhe 7 (A. S.), e cila ekspertizë përputhet edhe me ekspertizën plotësuese që është bërë nga ekspertja e grafologjisë L. Sh., dhe verifikuesi dytë FeR. S., specialist i lartë për dokumente dhe dorëshkrime, ku në konstatim dhe mendim përfundimtar kanë theksuar se duke u bazuar në të gjeturat- karakteristikat e përgjithshme dhe individuale vinë në përfundim që shkrimi në dëshminë 6 është i shkruar nga personi i njëjtë me mostrat e shkrimeve nga dokumenti në dëshminë #2 dhe 3, pra që i përkasin të akuzuarës V. Ll.. Po ashtu gjykata ka hedhur poshtë pretendimet e të akuzuarës se e njëjta nuk ka ndërhyrë në testin me shkrim të J. A.t, ngase kjo mbrojtje është në kundërshtim me provat e siguruar nga prokuroria pasi që nga të gjithë anëtarët e komisionit është plotësuar formulari për marrjen e dorëshkrimeve dhe nënshkrimeve dhe po ashtu nga e akuzuara V. Ll. është plotësuar formulari për marrjen e dorëshkrimeve dhe nënshkrimeve dhe pas ekzaminimit dhe ekspertimit ku janë përdorur rezet floroshente dhe në faqen e parë të dokumentit në fjalë janë identifikuar dy ngjyra të ndryshme të lapsit kimik që do të thotë sipas bindjes së gjykatës që një laps është përdorur nga e akuzuara J. A. dhe lapsi tjetër nga e akuzuara V. Ll., është marrë pas ekzaminimit të ekspertëve të grafologjisë nga ekspertët dhe kanë ardhur tek mendimi përfundimtar se dorëshkrimi nga dokumenti në dëshminë 1 (testi me shkrim) me numër Ref.006/05/2017 në emër të J. A., është i shkruar nga personi i njëjtë i cili ka shkruar dorëshkrimet, mostrat të njohura të evidentuara në dëshminë 5 (formulari për marrjen e dorëshkrimeve dhe nënshkrimeve) të datës 15.08.2019, me dorëshkrime të V. Ll., dorëshkrimi i lartcekur është ekspertuar dhe krahasuar me dorëshkrimet dhe mostrat të njohura të evidentuara në dëshminë 2 (J. A.), 3 (Z. M.) 4 (A. K.), 6 (J. Ll.) dhe 7 (A. S.) mirëpo nuk janë identifikuar karakteristikat e përgjithshme dhe individuale që përputhen në mes tyre, që do të thotë se dorëshkrimi i lartcekur nuk është shkruar nga personat e lartpërmendur por nga këtu e akuzuara V. Ll.. Po ashtu gjykata ka hedhur poshtë pretendimet e të akuzuarës se në testin me shkrim të kandidatës J. A. ka ndërhyrë këtu dëshmitari J. H., i cili është procedura në shqyrtimin gjyqësor si dëshmitarë dhe nga dëshmia e tij është vërtetuar që i njëjti është nënkryetar i sindikatës dhe se i njëjti ka të drejtë të shkojë si vëzhgues gjatë pranimit të kandidatëve mirëpo ka deklaruar se nuk ka të drejtë të ndërhyjë por vetëm të vëzhgojë gjatë procesit të testimit dhe sa i përket rastit konkret nuk i kujtohet a ka qenë prezent gjatë testit me shkrim të kandidatëve për vendin e punës ku është pranuar kandidatja J. A.. E akuzuara gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka pasur pyetje për dëshmitarin J. H., e pasi që i njëjti ka nderuar jetë e njëjta në seancën e shqyrtimit gjyqësor gjatë mbrojtjes ka deklaruar që në testin me shkrim të J. A.t ka ndërhyrë dëshmitari J. H., si përfaqësues i sindikatës edhe se këtë ndërhyrje që e ka bërë J. H., e ka parë edhe dëshmitarja L. Ll., e cila prapë është marrë në pyetje në cilësinë e dëshmitares, dhe e njëjta ka mohuar që e ka parë dëshmitarin J. H. që ka ndërhyrë në testin e J. A.t.

Po ashtu gjykata ka hedhur poshtë propozimin e mbrojtësit të akuzuarës V. Ll., av. Prenk Pepaj, i cili i ka propozuar gjykatës që në këtë çështje të bëhet super-ekspertizë, pasi që në këtë

çështje penale është bërë ekspertiza nga ekspertët e Grafologjisë në AKF, dhe nga kjo ekspertizë dhe ekspertiza plotësuese ka qenë identike në mendimin përfundimtar, andaj gjykata ka refuzuar këtë propozim si të pa bazuar, ngase super-ekspertizë bëhet kur kemi dy ekspertiza me mendim përfundimtar të ndryshëm e me qëllim të eliminimit të dilemave urdhërohet super-ekspertizë, e që në rastin konkret është refuzuar ky propozim si i pa bazuar.

Gjykata ka vërtetuar se në rastin konkret këtu e akuzuara me dashje ka ndërhy në testin e kandidatës J. A. duke i plotësuar pyetjet me plotësime shtesë me çrrastë i ka shkaktuar dëme kandidatëve tjerë dhe në këtë mënyrë ka favorizuar kandidaten J. A. duke keqpërdorë pozitën e sajë zyrtare si anëtare e komisionit dhe se me këto veprime e njëjta i ka tejkaluar kompetencat e saja.

Andaj Gjykata konsideron se në rastin konkret se përtej çdo dyshimi të bazuar është vërtetuar plotësisht gjendja faktike si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi, përkatësisht se në veprimet e të akuzuara V. Ll., manifestohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, në kohë, vend dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket dispozitivit II të akuzës për veprë penale falsifikim i dokumentit nga neni 343 par.1 të KPRK-së, gjykata ka marr aktgjykim refuzues, pasi që përfaqësuesi i akuzës prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare sa i përket të akuzuarës V. Ll. për këtë veprë penale është tërhequr nga akuza konform dispozitave të nenit 363 par.1 pika 1 të KPRK-së.

Po ashtu gjykata ka hedhur poshtë pretendimet e mbrojtësit të akuzuarës J. A. av.Fadil Sinanaj, i cili pretendon se këtu e akuzuara J. A. nuk ka kryer veprë penale për të cilën akuzohet ngase e njëjta gjatë mbrojtjes së vetë ka deklaruar se nuk ka qenë në gjendje të mirë shëndetësore për shkak të ngarkesave familjare dhe stresit që është gjendur në stacionin policor, nuk ka pasur ndriçim adekuat gjatë marrjes në pyetje, dhe kohës së shkurtër të shikimit të testit me shkrim, ku e njëjta nuk ka arrite të lexoi dhe pas pyetjeve nga zyrtarët policor se a është shkrimi i sajë në testin me shkrim që është prezantuar e njëjta ka deklaruar se po andaj në bazë të kësaj është ngritur akuza për deklarim të rremë dhe se e njëjta nuk ka pasur njohuri se a është ndërhyrë në testin e sajë mirëpo pretendimet e mbrojtjes janë të pa baza ngase këtu e akuzuara J. A. në deklaratën që ka dhënë në cilësi të dëshmitares me datë 08.08.2019, në Stacionin Policor në Gjakovë, në pyetjen e parashtruar nga zyrtari policor se a është ky shkrimi i juaj plotësisht në testin origjinal të datës 09.06.2017, apo ka edhe ndërhyrje në test, e njëjta pas prezantimit të testit origjinal është përgjigjur se ky shkrim është plotësisht i imi, e në pyetjen pasuese se në testin origjinal shihen dy lloje të ngjyrave të stilolapsit, si mund të na shpjegoni këtë, e njëjta ka dhënë përgjigje se unë kam filluar me teste dhe sipas pyetjeve të cilat i kam ditur dhe i kam plotësuar duke përdorur dy stilolapsa, andaj nga këto veprime dhe përgjigjet e dhëna në cilësinë e dëshmitares e njëjta e ka ditur që deklarata e sajë dhënë në lidhje me këtë çështje penale nuk përputhet me realitetin përkatësisht ka qenë e vetëdijshme se deklarimi është i pa vërtetë, e njëjta ka pasur njohuri se testi me shkrim i përpiluar nga ana e sajë është bërë me plotësimin shtesë me ç' rast i ka shkaktuar dëm kandidatëve tjerë dhe se në rastin konkret janë përdorur edhe dy stilolapsa, një stilolaps nga e akuzuara V. Ll. dhe tjetra nga këtu e akuzuara J. A. pra në rastin konkret e akuzuara J. A. ka deklaruar rrejshëm dhe nuk përputhet me realitetin ngase e njëjta ka ditur që është ndërhyrë në test duke u plotësuar testi me plotësime shtesë ku kjo është vërtetuar edhe nga ekspertiza e eksperteve të grafologjisë, andaj pretendimet e mbrojtjes janë refuzuar si të pa bazuara pasi që e akuzuara deklarimin e dhënë para organit kompetent te zyrtari policor në cilësi të dëshmitares, rrejshëm ka deklaruar që testi është plotësuar plotësisht nga e njëjta por gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar e kundërta që në testin e sajë ka ndërhyrje shtesë me ç' rast janë dëmtuar kandidatët tjerë që kanë aplikuar në këtë konkurs.

Andaj gjykata konsideron se në rastin konkret përtej dyshimit të bazuar është vërtetuar plotësisht gjendja faktike si në dispozitivin III të këtij aktgjykimi, përkatësisht se në veprimet e të akuzuarës J. A. formohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale deklarime të rreme nga neni 392 par.1 të KPRK-së.

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarave V. Ll. dhe J. A. Trupi Gjykuese ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nënti 73 dhe 74 të KPRK-se, në këtë aspekt si rrethane lehtësuese ka marrë parasysh sjelljen korrekte të pandehurave në shqyrtim gjyqësor, e pandehura e parë është mbajtëse e vetme e familjes, nënë e dy fëmijëve, me herët nuk ka qenë e gjykuar, dhe të njëjtës gjykata i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 ( gjashtë ) muajve, i cili dënim është në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallen e përgjegjësisë penale dhe pas shqiptimit të këtij dënimi Trupi Gjykuese të pandehurës dhe mbrojtësit e saj i ka njoftuar që ky dënim mund të zëvendësohet me dënim me gjobe andaj me kërkesën dhe pëlqimin e tyre Gjykata dënimin me burgim e ka zëvendësuar me dënim me gjobe pasi që janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 47 të KPRK-se, ndërsa për të akuzuarën J. A. gjykata ka marrë parasysh si rrethanë lehtësuese sjelljen korrekte të akuzuarës në shqyrtim gjyqësor, është mbajtëse e vetme e familjes, nënë e tre fëmijëve, më herët nuk ka qenë e gjykuar, dhe të njëjtës i ka shqiptuar dënimin me gjobë me shpresë dhe bindje se ky dënim i shqiptuar me gjobë është në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së saj penale andaj me dënimet e shqiptuara me gjobe do të arrihet qëllimi i dënimit i parapare me dispozitat e nënti 41 të KPRK-se, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarave nga kryerja e veprës penale në të ardhmën dhe të beje rehabilitimin e tij të parandaloi persona tjetër nga kryerja e veprës penale dhe të shpreh gjykimin shoqërore për vepër penale, ngritjen e moralit dhe forcimit të detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata ka hedhur poshtë propozimin e prokurorisë që ndaj të akuzuarës V. Ll. të shqiptoi dënim plotësues, ndalimi i ushtrimit të profesionit mjekësor përkatësisht Doktorësh-Internistë-Polmulogë në Spitalin “Isa Grezda” në Gjakovë, në kohëzgjatje prej një (1) viti, për arsye se ky shqiptim i dënimit plotësues nuk është i lidhur me keqpërdorimin e detyrës zyrtare gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare në cilësinë e Doktorëshës-Internistë-Polmulogë por e njëjta ka vepruar në cilësinë e anëtares së komisionit që nuk është lidhur me keqpërdorim të detyrës në cilësinë e doktorëshës.

Duke e pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe duke u bazuar në nenet 451 paragrafi 1 dhe 453 të KPP-së si dhe konform nenit 39 paragrafi.3 nënparagrafi.3.2 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, kryetari trupi gjykues ka vendosur që të akuzuarat t’i paguajnë shpenzimet e paushallit gjyqësor si dhe shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, komfor nenit 365 të KPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**- Departamenti Për Krime të Rënda -**  
**PKR.nr.96/2020, me datë 12.10.2021**

**Sekretare juridike,**  
**Nushe Kadrija**

**Kryetari i trupit gjykues,**  
**Shaqir Zika**

Numri i lëndës: 2019:285072  
Datë: 12.10.2021  
Numri i dokumentit: 02272002

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.